



VENDIM

Nr.51, Datë 31.03.2017

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALBTEK ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
IMPIANTI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, ME FUQI TË
INSTALUAR 2850 KW.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”; “d” është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Ministria e Mjedisit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues të marrëveshjes së konçesionit, me subjektin Albtek Energy sh.p.k. ka lidhur marrëveshjen e konçesionit nr 11026/7 prot date 16.12.2014 për një afat 7 vjeçar.
- Subjekti Albtek Energy sh.p.k. nuk ka bërë me dije datën e fillimit të operimit të impiantit pas përfundimit të afatit si më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane” me fuqi të instaluar 2850 KW. Afati i licensës do të zgjasë deri në përfundim të kontratës së konçesionit.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI